



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr.1122/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Milena Đerić kryesuese, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë-dega në Vushtrri, për thyerjen e heshtjes zgjedhore, për raundin e Dytë për Zgjedhjet Lokale, të datës 14.11.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 15.11.2021, mori këtë:

### **V E N D I M**

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa Anr.1122/2021 e datës 14.11.2021 e paraqitur nga Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me të cilën ka kërkuar që subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës t'i shqiptohet gjobë për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 14.11.2021.

### **A r s y e t i m**

Pzap me datën 14.11.2021 ka pranuar ankesën me numër Anr.1122/2021, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën pretendon se aktivistet e sajë nga Qendra në Prishtinë me datën 14.11.2021 rreth orës 09:00, kanë vërejtur se kandidati për kryetar të Komunës së Vushtrrisë nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës Xhafer Tahiri, ka thyer heshtjen zgjedhore duke vazhduar sponsorizmin e postimit me përmbajtje elektorale të cilat janë shfaqur në rrjetin e tij social Facebook, duke bërë thirrje që të votohet subjekti i tij politik LDK. Më tutje pretendojnë se sponsorizmi i postimit siç vërehet ka vazhduar në kohën e heshtjes zgjedhore, dhe kjo mund të vërtetohet edhe nga provat e bashkangjitura në ankesë ku vërehet ora dhe data e sakte e postimit, të marruar nga platforma e rrjetit social facebook .

PZAP-i me datën 14.11.2021 e njoftoi subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me ankesën e parashtruar dhe kërkoi nga e njëjta që deri me datën 14.11.2021 në orën 18:00, të përgjigjet në ankesë.

Në përgjigje në ankesë, subjekti politik LDK, i kundërshton pretendimet e ankuesit, ngase foto e bashkangjitur nuk provon diçka konkrete e as pretendimin e ankuesit, se gjatë heshtjes zgjedhore ka vazhduar sponsorizoi i videos të Xhafer Tahiri, kjo është supozim i rrëzueshëm juridik, për qka gjeni provën konkrete të dëshmuar përmes CD-së të bashkangjitur si prove direkte. Andaj, subjekti politik LDK i propozon PZAP-së që ankesa e subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosje të hudhet si e pabazuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

#### **Ankesa është e pabazuar**

Paneli, konform nenit 8 par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 02/2015, me datë 14.11.2021 ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se e njëjta është e pabazuar ngase nuk ka qenë e mundur të vërtetohet në rrugë elektronike nëse e njëjta me datën 14 nëntor 2021 ka qenë aktive, pasi që në kohën e testimit e njëjta ka qenë jo aktive.

Duke marrë parasysh të cekurat më lartë, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve për ankesat, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret të provuarit e asaj se shkelësi i supozuar me datë 14.11.2021, e ka vazhduar sponsorimin e fushatës zgjedhore në rrjetin social “Facebook”, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore dhe ditën e votimit.

Nga provat e ofruara nga ankuesi, nuk mund të vërtetohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se reklama e shkelësit të supozuar është publikuar apo ka vazhduar sponsorimi i fushatës zgjedhore edhe në ditën e heshtjes zgjedhore dhe ditën e votimit, edhe pse parashtruesi i ankesës ka paraqitur fotografi me të cilat pretendon se postimi i sponsorizuar ka qenë aktiv në ditën e votimit, paneli këto pretendime nuk mundi ti vërtetoj sepse me asnjë provë shkresore nuk është argumentuar ashtu siç pretendohet në ankesë.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr.1122/2019 më datën 15.11.2021

**Kryesuese e Panelit**

**Milena Đerić**



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në *Gjykatën Supreme të Kosovës*, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.